



RAPORT VJETOR I KONSULTIMIT PUBLIK PËR VITIN 2025, PËR MINISTRINË E ARSIMIT

1. Përmbledhja ekzekutive

Gjatë vitit 2025, Ministria e Arsimit ka miratuar një vendim për të cilin ka patur detyrimin e konsultimit publik, si më poshtë:

“Vendim nr. 733, datë 3.12.2025 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale”.

Procesi i konsultimit është kryer nëpërmjet publikimit në RENJKP në periudhën 4.8.2025-1.9.2025. Procesi i konsultimit nuk është shoqëruar me komente pas publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, por janë përcjellë sugjerime në rrugë elektronike nëpërmjet adresës së email-it të koordinatorit të konsultimit publik në Ministrinë e Arsimit.

Gjatë vitit 2025, MA ka publikuar për konsultim publik, gjithashtu, projektligjin “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore”, konsultimi për të cilin ishte i hapur në datat 9.7.2025 deri në datën 6.8.2025, nga ku në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike nuk pati komente/sugjerime, por janë përcjellë sugjerime nëpërmjet takimeve konsultative të organizuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Komente/sugjerime nga disa palë të interesuara, janë marrë kryesisht nëpërmjet takimeve të grupit të punës dhe atyre të ardhura me postë elektronike. Një pjesë e këtyre komenteve/sugjerimeve janë përfshirë në procesin e vendimmarrjes, duke u integruar në tërësi, në përmbajtjen e projekt akteve.

Ndërkohë nga monitorimi i regjistrit elektronik të konsultimit publik, rezulton se nuk ka pasur komente, ndaj nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik mbetet një nga sfidat kryesore të gjithë administratës publike në drejtim të konsolidimit të konsultimit publik, si një hallkë thelbësore në zinxhirin e procesit të hartimit të legjislacionit.

Pra, gjatë vitit 2025, Ministria e Arsimit ka realizuar 100% planin e saj të konsultimit publik, të akteve të miratuara, objekt i ligjit nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, që është vendimi nr. 733, datë 3.12.2025 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale”.

Për aktet e konsultuara, të përmendura më lart, është publikuar raporti final për projekt aktin e konsultuar dhe miratuar i cili është përgatitur, duke vlerësuar dhe synuar përfshirjen në mënyrë shteruese të kontributit, përmes komenteve dhe rekomandimeve të grupeve të interesit, qytetarëve, të aktorëve të jashtëm jo-qeveritarë, anëtarëve të organeve këshillimore. Gjithashtu, publikimi i raportit final në RENJK, përpara miratimit të aktit në Këshillin e Ministrave, ka si qëllim rritjen e transparencës, nxitjen e publikut për të dhënë mendime, sugjerime e rekomandimeve në mënyrë të vazhdueshme mbi çdo projekt akt apo edhe krijimin e mundësisë efektive dhe efikase për të parë rezultatin e punës së tyre dhe për të reaguar sërish në rast mendimi ndryshe.

Procesi i konsultimit publik, krahasuar me vitin e mëparshëm është përmirësuar, lidhur me diversifikimin e mjeteve të përdorura për konsultim, rritjen e aksesit të qytetarëve në konsultim dhe në shkallën e reagimeve të mbledhura.

Përgjithësisht, qytetarët mbeten indiferentë ndaj përcjelljes së komenteve në RENJKP. Kryesisht, sugjerime përcjellin institucionet e interesuara.

Përforcimi i kulturës pjesëmarrëse dhe nxitja e publikut për të rritur përfshirjen në proceset e politik bërjes publik mbetet një nga sfidat kryesore në drejtim të konsolidimit të konsultimit publik.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Për vitin 2025, me propozimin e MA janë miratuar 26 akte, të cilat janë vendime të Këshillit të Ministrave.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Nga aktet e miratuara gjatë vitit 2025 është konsultuar me publikun një projekt akt, konkretisht vendimi nr. 733, datë 3.12.2025 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale”.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Nga aktet e miratuara gjatë vitit 2025 që kanë pasur detyrimin e konsultimit publik, akti i miratuar (VKM) nuk bën pjesë në kategorinë e projekt akteve që shoqërohet me raport VNR.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Për aktet e programit analitik të vitit 2025 nuk janë përdorur kriteret/përfjashtimet nga konsultimet publike, në zbatim të nenit 4(b) të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, pasi aktet e miratuara nuk bëjnë pjesë në kategorinë e projekt akteve që kanë detyrimin e konsultimit publik.

Për sa i përket PKIE dhe dokumenteve strategjike të sektorit, është konsultuar, 1 (një) projekt akt i planifikuar në PKIE, konkretisht vendimi nr. 733, datë 3.12.2025 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale” dhe nuk janë konsultuar ato projekt akte që nuk e kanë një detyrim të tillë, sipas ligjit. Në këtë kuadër nuk janë përdorur kriteret/përfjashtimet nga konsultimet publike për projekt aktet e miratuara, të cilat janë parashikuar në këto dokumente.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Projekt akti i konsultuar është vendimi i Këshillit të Ministrave që miraton dokumentin strategjik kombëtar “Planin e veprimit të agjendës digjitale për arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale”.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Në procesin e konsultimit janë përfshirë një numër i gjerë aktorësh, nëpërmjet disa metodave të përdorura, si RENJKP, takime konsultative, e-mail dhe sugjerimet e administruara janë reflektuar si në raportin individual të konsultimit ashtu edhe në relacionet përkatëse të këtyre akteve që i propozohen për miratim, Këshillit të Ministrave, duke pasqyruar nëse ato janë pranuar ose jo. Në krahasim me vitin 2024, projekt aktet janë publikuar në sistemin e informacionit të qeverisë (RENJKP) si dhe janë realizuar takime duke dhënë informacion të mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit si dhe janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre nëpërmjet raporteve individuale.

2.2. Metodat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Për të zhvilluar konsultimet publike, u përdoren këto metoda:

- Publikimi i projektvendimit në RENJKP;
- Njoftimi dhe konsultimi me anë të takimeve konsultative dhe zhvillimi i takimeve publike;
- Shkresa zyrtare dhe posta elektronike.

Për aktin e miratuar janë marrë komente nëpërmjet postës elektronike drejtuar koordinаторit të konsultimit publik në MA, pasi ishin njohur me projekt aktet nëpërmjet faqes zyrtare të konsultimit publik. Nga konsultimet publike të kryera, janë marrë komente/sugjerime vetëm nga posta elektronike. Nisur nga ky fakt, kjo metodë konsultimi rezulton të jetë metoda më efikase.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të aktorëve të përfshirë në procesin e konsultimit publik ishte posta elektronike.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Vendimi nr. 733, datë 3.12.2025 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale”, nuk ka pasur konsultim të hershëm me grupet e interesit.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Për vendimin nr. 733, datë 3.12.2025 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale”, procesi i konsultimit është kryer në datat 4.8.202-1.9.2025. Procesi i konsultimit nuk është shoqëruar me komente pas publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, por janë përcjellë sugjerime në rrugë elektronike nëpërmjet adresës së email-it të koordinаторit të konsultimit publik në Ministrinë e Arsimit.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit publik është përgjithësisht ajo e përcaktuar nga ligji nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, 20 ditë pune.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Procesi, krahasuar me vitin e mëparshëm është përmirësuar, lidhur me diversifikimin e mjeteve të përdorura për konsultim dhe numrin e sugjerimeve të marra nga publiku ku kryesisht, sugjerime përcjellin subjektet e interesuara.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Në grupin e punës për hartimin e aktit nuk ka pasur përfaqësues të jashtëm, jo-qeveritarë.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Në grupet e punës nuk ka pasur anëtarë të jashtëm, përfaqësues të subjekteve të tjera.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Për të gjitha projekt aktet e konsultuara rezulton se ka marrë pjesë, 1 aktor, i cili dha komente në kuadër të financimit për mbështetje me infrastrukture digjitale, të mësuesve.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Kontribuuesi ka qenë organizatë jo fitimi prurëse, Këshilli i Prindërve Tiranë.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Numri i pjesëmarrësve ka qenë më i ulët, dhe sugjerimet e marra po ashtu dhe përgjithësisht pjesëmarrja lidhet kryesisht me organizma që janë të përfshirë në zbatimin e projekt aktit.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Në konsultimin e realizuar për të gjitha projekt aktet është marrë në total 1 rekomandim. Duke qenë se numri i akteve të konsultuara ka qenë 1, mesatarja është 1 sugjerim për projekt akt.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Sugjerimi i përcjellë është pranuar pjesërisht duke qenë se lidhej me efekte financiare të cilat në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, nuk i takojnë buxhetit të shtetit.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin 2024 ka patur numër më të ulët sugjerimesh dhe përfshirja e grupeve të interesit mbetet e ulët dhe përgjithësisht nxitet nga institucioni nëpërmjet takimeve të zhvilluara.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Nga aktet e miratuara gjatë vitit 2025 që kanë pasur detyrimin e konsultimit publik, akti i miratuar nuk bën pjesë në kategorinë e projekt akteve që shoqërohet me raport VNR.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Ministria e Arsimit ka publikuar dy raporte individuale të konsultimit publik, një për aktin e miratuar që ka pasur detyrimin e konsultimit publike konkretisht vendimi nr. 733, datë 3.12.2025 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale” dhe një për projektligjin “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore”.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Të gjitha raportet individuale të konsultimit publik janë publikuar.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik

Si konkluzion konstatohet se procesi i konsultimit publik referuar të gjitha akteve është mesatarisht 8 pikë nga 8 të mundshme, kjo për shkak të konsultimit të të gjithë projektakt akteve që kanë detyrimin e konsultimit publik.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfida kryesore mbetet nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik. Për të bërë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së publikut, nëpërmjet dhënies së mendimeve/sugjerimeve kërkohet angazhimi i të gjitha institucioneve shtetërore, të përfshira në procesin e konsultimit.

Me qëllim përmirësimit të cilësisë së procesit, sugjerohet ndërgjegjësimi edhe më tepër, përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik, në përshtatje me zhvillimet më të fundit të mjeteve të informacionit.

Në përfundim mund të themi që procesi i konsultimit publik, pavarësisht se është një praktikë që ndiqet prej kohësh tashmë, paraqet sfida të ndryshme, që lidhen herë me kulturën apo interesin e publikut në pjesëmarrjen e procesit të konsultimit publik, herë me natyrën e aktit.